



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM  
Nr.125, datë 29.05.2023

PËR  
“CAKTIMIN E ZOTIT PLATIN ALIÇKA NË DETYRËN E PROKURORIT  
NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË  
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, NËPËRMJET  
PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 90, pika 2 të “Kodit të Procedurave Administrative”, nenin 41 dhe 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164, pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 44 dhe 45 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të paraqitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Caktimin e zotit Platin Aliçka në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në pozicionin vakant Nr.4, shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.332, datë 19.12.2022.
2. Relacioni i Komisionit për Zhvillimin e Karrierës është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Platin Aliçka, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi më datë 14.06.2023 dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 29.05.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR  
Alfred Balla

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Bujar Sheshi

ANËTAR  
Nurhan Seiti



ANËTAR  
Elaida Goxhi

ANËTAR  
Esmeralda Keshi

ANËTAR  
Zeqir Hoda

ANËTAR  
Mirela Bogdani

ANËTAR  
Arta Mandro

ANËTAR  
Ledina Riza



*[Faint handwritten signature or text at the bottom center]*